



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-CC-2019-07

**Vendosi:** **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**  
Gjykatës Vidar Stensland, kryetar i panelit  
Gjykatës Roland Dekers  
Gjykatës Antonio Balsamo

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 20 nëntor 2019

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Përmbledhje e vendimit lidhur me kërkesën e Prokurorisë për riklasifikimin e parashtrimit KSC-CC-2019-07/F00001**

---

**Parashtruesit**

Driton Lajçi

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

1. Më 14 nëntor 2019, z. Driton Lajçi ("Parashtruesi") i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese një kërkesë referuese që mban datën 13 nëntor 2019 ("Kërkesa Referuese"), në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesi përfaqësohet nga z. Tobi Kadman.
2. Më 15 nëntor 2019, në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi panelin e Gjykatës Kushtetuese me përbërje si më lart, për të vendosur në lidhje me Kërkesën Referuese.
3. Më 15 nëntor 2019, Zyra e Prokurorit të Specializuar dorëzoi një kërkesë për riklasifikimin e Kërkesës Referuese (KSC-CC-2019-07/F00001) nga publike në konfidenciale ("Kërkesa"), në bazë të rregullës 11 të Rregullores së Punës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.
4. Më 17 nëntor 2019, Parashtruesi dorëzoi përgjigjen ndaj Kërkesës ("Përgjigja"). Parashtruesi i kërkoi panelit që ta refuzonte Kërkesën.
5. Pas shqyrtimit të Kërkesës dhe të Përgjigjes, paneli vendosi që ta refuzojë Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Arsyet e marrjes së këtij vendimi të përmbledhur paneli do t'i parashtrojë në vendimin në lidhje me Kërkesën Referuese. Rrjedhimisht, Kërkesa Referuese (KSC-CC-2019-07/F00001) mbetet e klasifikuar si publike.

## **PËR KËTO ARSYE, PANELI I GJYKATËS KUSHTETUESE**

*Refuzon* Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për riklasifikimin e Kërkesës Referuese (KSC-CC-2019-07/F00001) nga publike në konfidenciale.

/nëshkrim/

**Gjykatës Vidar Stensland**

**Kryetar i panelit**

Hartuar në anglishte, e mërkurë, 20 nëntor 2019

Në Hagë, Holandë